

Universiteti i Elbasanit pjesë e takimit të 5-të të projektit LAIA në Prizren

Në Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren u zhvillua takimi i 5-të i projektit LAIA (Laboratory on Artificial Intelligence in Albania and Kosovo), i cili mbledhi së bashku përfaqësues të universiteteve partnere për të diskutuar ecurinë e projektit dhe hapat e ardhshëm për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Në këtë takim morën pjesë koordinatorët e projektit nga University of Piraeus, si dhe partnerët nga University of Southern Denmark, Universiteti i Elbasanit, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Përfaqësuesit e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" morën pjesë aktivisht në diskutimet e zhvilluara gjatë takimit, duke kontribuar në vlerësimin e progresit të projektit, shkëmbimin e përvojave ndërmjet partnerëve dhe planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.

Gjatë punimeve u trajtuan gjithashtu aktivitetet e lidhura me Hackathon-in për Inteligjencë Artificiale në kuadër të ITP-së, ku universitetet partnere të projektit LAIA janë të angazhuara në organizim dhe mbështetje, ndërsa studentë nga institucionet partnere marrin pjesë aktivisht në këtë nismë.



